REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**
**DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL**

# RELACION

## MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË MBROJTJES CIVILE TË BASHKISË, PËR TË MBËSHTETUR SHTRESAT NË NEVOJË NË KUSHTET E EPIDEMISË SË SHKAKTUAR NGA COVID-19

***Të nderuar Këshilltar !***

Situata aktuale e pandemisë Covid-19 dhe izolimi social ka vene ne veshtiresi social-ekonomike nje pjese te familjeve te Bashkise se Beratit.

Institucioni i Bashkise Berat është angazhuar maksimalisht për përballimin me efikasitet te kesaj situate. Menjehere pas evidentimit te rasteve te para me Covid-19 ne Shqiperi, me Urdher Nr. 169, Datë 19.03.2020, ne Bashkinë Berat u ngrit Shtabi Koordinues si dhe me urdhërin Nr. 170, Datë 19.03.2020, u ngriten Njësite Koordinuese në Terren. Këto struktura po punojne për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë ne kushtet e epidemise se shkaktuar nga Covid-19.

Bazuar në VKM-në Nr 236, date19.03/2020, strukturat tona të Shërbimit Social u mobilizuan tërësisht për të konfirmuar listën e subjekteve përfituese, përpiluar nga Shërbimi Social Shtetëror dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Përcaktimi i masës së produkteve ushqimore dhe joushqimore të kategorive sipas VKM nr.236 dt 19.03.2020 i referohet Vendimit Nr.2, datë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

familje me produkte ushqimore do te jetë e përafërt me atë të shtresave të parashikuara në VKM nr.236, datë 19.03.2020.

Nga analiza që kemi kryer, duket që këto familje të cilat janë evidentuar, ndodhen në kushte shumë të vështira ekonomike dhe situata aktuale e shkaktuar nga virusi Covid-19 e ka renduar edhe me tej gjendjen e tyre social-ekonomike, duke i vene ne veshtiresi per perballimin e jetesës së perditeshme. Bashkia Berat do të hartoj një liste të përbërë nga 1200 familje të që jetojnë në territorin administrativ të saj.

Ju faleminderit!

**PRGJ/SEK**
**Piro Xheblati**

**DREJTORI I SHËRBIMIT SOCIAL**
**Juvina Qevani**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**

**KËSHILLI BASHKIAK**

# PROJEKTVENDIM

**Nr. ______, datë __________2020**

## MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË MBROJTJES CIVILE TË BASHKISË, PËR TË MBËSHTETUR SHTRESAT NË NEVOJË NË KUSHTET E EPIDEMISË SË SHKAKTUAR NGA COVID-19

Në mbështetje të nenit 8, të gërmës "b", pika 1.1 të nenit 9, pikës 1 të nenit 24, 40, 54, neni 64/c të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr.68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore, ligjin nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", VKM nr.236,datë 19.03.2020, "Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19" dhe VKB nr.66, datë 26.12.2019, "Per miratimin e buxhetit të vitit 2020 dhe PBA përfundimtare 2020-2022", me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e shumës prej 6.500.000 (gjashtëmilion e pesëqindmijë) lekë për të ndihmuar 1200 familje në nevojë, ku perfshihen shtresat në nevojë sipas përcaktimit në VKM nr.236,datë 19.03.2020, si edhe familjet në varfëri ekstreme të evidentuara nga shtabet koordinuese në terren të drejtuara nga Administratorët, me produkte ushqimore dhe joushqimore, minimal, në kushtet e epidemisë të shkaktuar nga COVID-19.

2. Shuma prej 6.500.000 (gjashtëmilion e pesëqindmijë) lekë të përballohet nga fondi për mbrojtjen civile.

3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Social , Drejtoria e Menaxhimit Finaciar dhe të Ardhurave dhe Drejtoria e Emergjencave Civile, Pronave dhe